



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

---

Shpetim Jaha  
Drejtor  
Radio Top Iliria  
R074  
Deçan

Vendimi LIC: 2008/05  
Ref: 0806/0938/CIMC/ni

**VENDIM**

*lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Top Iliris*

---

**Fakte**

1. Parashtruesi i kërkesës është subjekt transmetues privat në Deçan. Ky subjekt transmetues ka pranuar licencën e modifikuar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media më 30 maj 2005.
2. Më 30 maj 2008, Komisioni i Pavarur për Media ka pranuar një kërkesë nga drejtori i Radio Top Iliris z. Shpetim Jaha lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, për të kaluar nga lokacioni i tanishëm i transmetimit në Rr. Dëshmoret e Kombit pn, në një lokacion të ri me adresë Rr. Luan Haradinaj pn që përbën një ndryshim të lokacionit të transmetimit në një distancë përafërsisht prej 100 metrash.

**Arsyetimi**

3. Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-15 është themeluar Komisioni i Pavarur për Media dhe Transmetim i cili është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës për rregullimin e Spektrit të Frekuencave të Transmetimit, për lëshimin e licencave dhe mbledhjen e taksave për licencë transmetimi.
4. Inxhinieret e Divizionit të Menaxhimit të Frekuencave (DMF) të KPM-së, me 18 qershor 2008 kanë bërë një vizite në Deçan dhe me këtë rast kanë marrë koordinatat e vendit në të cilin kërkon që ta vendos sistemin e transmetimit Radio Top Iliria. Kështu që sipas vlerësimeve teknike të inxhinierëve të DMF-së ndryshimi i lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Top Iliria, duke kaluar nga lokacioni i licencuar në koordinatat gjeografike N 42° 32' 23' dhe E 20° 17'

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Prishtina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Prishtina

00" në lokacionin e ri të propozuar në koordinatat gjeografike N 42° 32' 77.4" dhe E 20° 17' 51.3" nuk do të ketë ndryshime në zonën e mbulimit të Radio Top Iliria, dhe gjithashtu nuk paraqet ndryshime të Pjesës 2 dhe 4 të licencës së KPM-së.


5. Prandaj, DMF vlerëson se kalimi i Radio Top Iliria në vendin e propozuar me anë të kërkesës dhe transmetimi në koordinatat e lartpërmendura është në pajtim me Kushtet dhe Termet e Licencës së KPM-së.
6. Këshilli i KPM-së në pajtim me vlerësimin e lartpërmendur nxjerr këtë:

### Vendim

7. Këshilli i KPM-së pajtohet me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Top Iliria, duke kaluar nga lokacioni i licencuar i cili gjendet në Rr. Dëshmorët e Kombit pn, në lokacionin e propozuar me kërkesë i cili gjendet në Rr. Luan Haradinaj pn, sipas koordinatave të përcaktuara nga DMF.
8. Këshilli i KPM-së konkludon se me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit nuk do të ketë ndryshime të Pjesës 2 dhe 4 të licencës së Radio Top Iliria.
9. Këshilli i KPM-së pajtohet që Radio Top Iliria të ndërrojë lokacionin e sistemit të transmetimit, përkohësisht deri në procesin e ri-licencimit.

### Lëshimi i Vendimit


10. Këshilli i KPM-së lëshon këtë vendim.

  
Argjentina Grazhdani  
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.



14/07/2008  
datë

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

  
Naife Selimaj Krasniqi  
Shefe Ekzekutive e KPM-së

14.07.08  
datë